

Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

Procesverbali i mbledhjes

Ref. 9/2012

Vendi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Data: 23 Nëntor 2012

Koha: 11:00 – 12:00

Pjesëmarrësit:

Robert Wright, *Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (kryesues);*

Gjylfidane Kadrijaj, *Drejtoare e Departamentit të Sistemit të Pagesave, BQK;*

Boryana Ivanova Mustafa, *Drejtoare e Pagesave dhe Thesarit, NLB ;*

Akile Cernobregu, *Drejtoare e Departamentit të Pagesave, PCB*

Erik Roka, *RBKO*

Edmond Jashari, *TEB;*

Edmond Murati, *MPMS;*

Fatmir Rashica, *Specialist për Kontroll të Pagesës, KEK;*

Teuta Kotorri, *PCB;*

Lindita Mehmeti, *Udhëheqëse e Departamentit të Operimeve dhe Thesarit, BEK*

Masar Baxhaku, *BQK;*

Takimi filloi në ora 11:00.

Diskutimet dhe prezantimet

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Z. Robert Wright njoftoi të pranishmit me konkluzionet nga takimi i fundit dhe me përmbushjen e tyre. U miratuan procesverbali dhe konkluzionet nga takimi i fundit i mbajtur më 19 Shtator 2012.

- **Prezantim i “Analizës mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave në Kosovë” dhe “Analizës për Kos-Giro”**

- a. Nga Analiza mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave në Kosovë, shihet rritja e numrit të instrumenteve dhe terminaleve të pagesave në Kosovë, njëkohësisht edhe rritja e përdorimit të këtyre instrumenteve të pagesave.

Sa i përket terminaleve ATM dhe POS u konstatua se në vazhdimësi ka pas rritje në numër dhe përdorim të tyre dhe se ekziston rrjet i gjerë i tyre në territorin e Kosovës, por përsëri niveli i përdorimit të tyre mbetet i ulët.

Përdorimi i kartelave nëpër terminaleve të pagesave është duke u rritur vazhdimisht me kalimin e kohës, edhe pse numri i transaksioneve të kryera me kartela vazhdon të mbetet i ulët. Nga numri i përgjithshëm i kartelave vetëm 57% e tyre janë kartela aktive të cilat përdoren në terminale të pagesave, prandaj duhet promovuar përparësitë e pagesave elektronike.

Si konkluzion i analizës u tha që Kosova ka infrastrukturë të mirë të instrumenteve dhe terminaleve të pagesës, por duhet kushtuar më shumë rëndësi promovimit dhe përdorimit të kësaj infrastrukture.

- b. Në analizën e Kos-Giro është paraqitur numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara përmes SEKN-së dhe brenda bankës, si përmes llogarive ashtu edhe në cash. Nga analizimi i të dhënave konstatohet për rritjen e numrit dhe vlerës së pagesave Giro nga viti në vit. Duhet inkurajuar klientët në kryerjen e pagesave Giro përmes llogarive pasi që qëllimi i pagesave Giro është edhe reduktimi i transaksioneve me cash.

- **Diskutim lidhur me mënyrën e bashkëpunimit me MasterCard dhe VISA**

Anëtarët e ekipit për menaxhim të projektit për reduktim të CASH-it rekomandojnë që bashkëpunimi të vazhdojë njëkohësisht me këto dy kompani, pasi që me secilën synohet të punohet me projekte të ndara.

Me VISA të punohet lidhur me web faqen edukative të cilën e kanë propozuar ata gjatë prezantimit të tyre para ekipës, ndërsa sa i përket bashkëpunimit me MasterCard, fillimisht ekipa pajtohet me propozimet e tyre të cilat i janë propozuar BQK-së që në fillim për reduktim të keshit, të dy variantet vlerësohen shumë dhe priten më shumë detaje nga ana e MasterCard lidhur me mënyrën e ofrimit të përkrahjes së tyre dhe njëkohësisht një plan më detal për koston dhe benefitet e qendrës procesue ndërbankare, qendër kjo që është e parashikuar edhe me strategji të sistemit kombëtar të pagesave, por fillimisht nuk ishin arritur pëlqimet formale nga akterët dhe mungonte asistencë teknike dhe financiare për projektin në fjalë.

- **Diskutime për Qendrën Procesuese Ndërbankare**

Lidhur me mundësinë e implementimit të qendrës procesuese ndërbankare, u tha që do të ndikonte pozitivisht në uljen e transaksioneve cash, duke rritur përdorimin e kartelave për kryerje të pagesave. Gjithashtu u rekomandua që me implementimin (fazat e ndryshme të zhvillimit) për “ Interbank Card Switch” të merrej konkretisht grupi punues në kuadër të Shtyllës së Tretë të strategjisë për zhvillimin e sistemit kombëtar të pagesave, anëtar të së cilës janë ekspert të fushës nga të gjitha bankat komerciale në vend.

- **Konkluzionet e Takimit dhe Hapat e ardhshëm**

- Inkurajimi i përdorimit të pagesave elektronike për kryerje të transaksioneve përveç tjerave forma të diskutuara edhe paraprakisht të inkurajohet edhe përmes zbritjes së tarifave për pagesa jo në cash;
- Të analizohet mundësia e zbritjes së tarifave për pagesat Kos-Giro (për të gjitha llojet, cash dhe jocash, vlen marrëveshja ende në fuqi në bazë të numrit të rritur), por më në veçanti apo menjëherë të analizohet zbritja për pagesat giro të cilat kryhen përmes llogarive bankare, me e-banking, përmes ATM-ve, etj. Të analizohet dhe përmes SHBK-ës të jepet një përgjigje brenda dy javëve;
- Për mundësinë e implementimit të qendrës procesuese ndërbankare siç është propozuar nga MasterCard, (bankat të dërgojnë komentet e tyre me shkrim brenda dy javëve, direkt apo edhe përmes SHBK-ës);
- Bankat të dërgojnë përgjigjet e tyre lidhur me propozimin që secila bankë (përfshirë edhe BQK-në) të kontribuojë me nga 2000 Euro në zhvillimin e kampanjave edukative për përdorim të pagesave përmes llogarive, shërbimet elektronike (brenda dy javëve).
- Takimi i ardhshëm do të mbahet në fund të janarit, 2013